



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **109**

Prishtinë, më 15.4.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Boban Todorović, Salih Morina.

Mungoi: Nijazi Idrizi, Daut Haradinaj, Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 8.4.2013,
3. Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për ujësjellës dhe kanalizim për vitin 2012,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Blegtori,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.4.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 8.4.2013.

3. Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për ujësjellës dhe kanalizim për vitin 2012

Kryetari Nait Hasani falënderoi për pjesëmarrje **Drejtorin Raif Pretenin** dhe për dërgimin e raportit me shkrim, njëherit e ftoi të paraqes raportin më shkurt pasi që në mbledhjen e parafundit debati lidhur me raportin ka filluar. Drejtori i zyrës (ZRRUK) me bashkëpunëtorët Sami Hasani dhe Qamil Musa falënderoi dhe njoftoi shkurtimisht Komisionin për punën e zyrës gjatë vitit 2012. Ai më hollësisht hyri në detale sipas raportit me shkrim duke shtuar se të dhënat në këtë raport do të verifikohen në muajin prill për tu publikuar në qershor të këtij viti. Ajo çka vlen të ceket, vazhdoi, është se humbjet e ujit ende vazhdojnë të janë breng e zyrës (60 %) ku ka pasur lëvizje pozitive vetëm 1%, ndërsa familjet konsumatorë janë mbuluar 91% me ujëmatës, çka gjithashtu mund të konsiderohet lëvizje pozitive.

Kryetari Nait Hasani falënderoi për raportin dhe kishte disa pyetje për disa çështje financiare, përkatësisht sa ka harxhuar zyra dhe sa nuk ka harxhuar, ndërsa drejtori u përgjigj se mund të konsiderohet si e arritur ngritja e përgjegjësisë në kompanitë dhe palët tjerë konsumatorë, por nëse bëhet krahasimi me vendet e rajonit tha se janë mbrapa, sa i përket çështjes së faturave paushallë përmirësimet janë duke ndodhur dhe qytetarët kanë qasje më të drejtpërdrejta.

Afërdita Berisha pyeti rreth mbulueshmërisë me ujë të pijes, përqindja 78% a është e saktë dhe a vlen për rrjetin apo për të gjitha zonat, çka tregojnë rezultatet e hulumtimeve të kënaqshmërisë së qytetarëve, pse ka lëvizje të vogla sa i përket humbjeve në ujësjellës, a ka ndryshime tek çmimet paushallë etj.

Sevdije Lama pyeti për njërën nga kompanitë (Radoniqi) pse ka realizim kaq të vogël, ndërsa **Salih Morina** pyeti sa është ritur numri i ujëmatësve gjatë vitit 2012, dhe a ka padi në gjykata për personat që nuk kryejnë obligimet, përndryshe lavdëroi raportin.

Drejtori fillimisht ceku se në WEB faqe janë publikuar shumë të dhëna të cilat përfshijnë edhe disa pyetje të parashtruara këtu, megjithatë shtoi se kënaqshmëria e qytetarëve nuk është në rritje përkundër faktit se ekziston këshillimorja për konsumatorë. Humbjet e ujit 60% janë shqetësim për zyrën, vazhdoi, mirëpo kjo është për shkak të rrjetit të dobët, megjithatë është duke u bërë studimi për zvogëlimin e humbjeve me çka shpresohet në rezultate pozitive, ndërkaq për Radoniqin tha se rezultate ka pasur pak për shkak të investimeve të vogla kapitale, përkatësisht nuk kanë investua sa kanë pasur, këto shënime edhe pak kohë do të janë më të sakta ngase tani janë duke u bërë evidentimet e investimeve për çdo kompani. Përmirësimi në vendosjen e ujëmatësve, vazhdoi me përgjigje, është në nivelin 10%, me çka janë zvogëluar faturat paushallë, gjithashtu këtu pritet ndërhyrja edhe nga ana e Qeverisë ndaj menaxhmentit. Lidhur me paditë e parashtruara në Gjykata tha se kanë më tepër punë me kompanitë ku ka pasur tri gjoba për ato, ndërsa me qytetarë shtoi se zyra ka mjaft shpenzime në këtë drejtim, ngase ka pasur raste kur për një padi është paguar 1400 euro. Për çmime tha se janë përafërsisht sikurse në rajon, 9 apo 10 euro për muaj për një familje, me ujëmatës. **Nait Hasani** theksoi se qyteti i Korçës është shembull i mirë me 100% mbulueshmëri me ujëmatës, ndaj sugjeroi një vizitë të Komisionit në këtë vend për të analizuar më mirë arsyetimin e ujëmatësve, ndërsa lidhur me **hartimin e Ligjit për ZRRUK** konstatoi se deri tani janë ndërmarr veprimet e duhura por duhet në vazhdim të kompletohen edhe disa veprime për të dërguar në procedim përfundimtarë në Kuvend, ai sugjeroi konsultimet ma stafin e komisionit për të bashkërenditur veprimet e nevojshme por fillimisht javën tjetër duhet të mbahet takimi i GP i cili do të konstatoi sa janë përmbushur obligimet deri tani dhe çfarë duhet të ndërmarrët më tutje. Komisioni nxori këtë :

REKOMANDIM

Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratoi në mbledhjen plenare Raportin vjetor për vitin 2012 nga Rregullatori për Ujësjellës dhe Kanalizim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Blegtori

Kryetari Nait Hasani ftoi zyrtarët e MB të prezantojnë ndryshimet e kërkuara nga Komisioni rreth projektligjit në fjalë dhe propozoi Komisionit të miratohen amendamentet si vijon :

Amendamenti 1

Neni 1, në Paragrafin 1 në fund fshihet “blegtorale”, ndërsa në Paragrafin 2, në rreshtin e 7 fjala “blegtorale” zëvendësohet me “**të kafshëve**”.

Amendamenti 2

Neni 2, Paragrafi 1, në rreshtin e 4 “kafshët blegtoriale” zëvendësohet me “**kafshë të fermës**”, ndërsa në fund të Nënparagrafit 1.3. fjala e fundit “të blegtorisë” bëhet “**blegtoriale**”.

Amendamenti 3

Neni 3, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.4, fjalia “është varieteti i jetës” zëvendësohet me “**llojlojshmëria**”.

Riformulohen Nënparagrafët 1.10, 1.12, 1.13, 1.21, 1.29 dhe 1.36 si vijon :

1.10. **Variabiliteti gjenetik** – ndryshueshmëria e tërësisë së gjeneve;

1.12. **Testi gjenetik** - përcaktimi i pranisë së një gjeni të caktuar te kafsha;

1.13. **Njësia blegtoriale** - njësia e përshkruar e krahasimit ndërmjet specieve dhe kategorive të kafshëve të fermave;

1.21. në rreshtin e parë fshihet “mashkull”.

1.29. **Programi racor** - metodat dhe masat e mbarështimit të llojeve apo racave specifike të kafshëve;

1.36. **Prodhimet me origjinë shtazore** - janë qumështi, mishi, vezët, leshti dhe prodhime të tjera me origjinë nga kafshët e fermës;

Shtohen katër përkufizime në fund :

1.43. **Blegtoria** – veprimtari e prodhimtarisë bujqësore e cila bazohet në mbarështimin e kafshëve shtëpiake për shfrytëzim ekonomik, prodhimin e ushqimit dhe nënprodukteve duke marrë parasysh vetitë biologjike të kafshëve dhe kërkesat etologjike të tyre.

1.44. **Jashtëqitjet e kafshëve** - bajga dhe urinë të cilat përdoren si pleh apo pleh i lëngshëm dhe amorf.

1.45. **Riprodhimi i kafshëve**- proces biologjik i shumimit seksual gjatë të cilit individut e gjinive të ndryshme të llojit të njejtë krijojnë pasardhës me veçori të kombinuara gjenetike të prindërve të tyre.

1.46. **Ministria** – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit Rural.

Amendamenti 4

Neni 7, Nënparagrafi 2.3 bëhet Paragrafi 3.

Amendamenti 5

Neni 10, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1. , në vend të numrit 6 të shkruhet 5.

Amendamenti 6

Neni 11, në titull fjala e parë të përmirësohet dhe shkruhet “**Pajisjet**”.

Amendamenti 7

Neni 15, zëvendësohet fjala “Organizatë” me “**Ndërmarrje**”.

Amendamenti 8

Neni 25, Paragrafi 4, në fund fjala “mbarsje” bëhet “**mbarsim**”, ndërsa në Paragrafin 5 rreshti 7 fjala “person” bëhet “**indiv**” dhe në vazhdim fshihet “individual”.

Amendamenti 9

Neni 27, fjala që përdoret në këtë Nen “Stacion” zëvendësohet me “**Qendra**”.

Amendamenti 10

Neni 28, Paragrafi 1 dhe 4, në rreshtin 4 dhe 6 përkatësisht 3, fjala “informacionit” zëvendësohet me “**informatik-e**”.

Amendamenti 11

Neni 32, në rreshtin e 5 pas fjalës “Ministria” shtohet “**Institucionet shkencore**”, ndërsa në rreshtin e 7 pas fjalës “prodhimeve” fshihet “blegtorale”.

Shtohet Paragrafi 3 :

3. Kriteret dhe procedurat e certifikimit të personave sipas Paragrafit 2 të këtij Neni përcaktohet me Akt nënligjor nga Ministria.

Amendamenti 12

Neni 37, Paragrafi 1, fjala e fundit “racore” zëvendësohet me “**riprodhuese**”.

Amendamenti 13

Neni 40, Paragrafi 1, në rreshtin e 4, pas “propozim të” shtohet “**Këshillit të blegtorisë dhe**”.

Amendamenti 14

Neni 41, riformulohet titulli i si vijon : **Kontrollimi krahasues i origjinës së racave dhe linjave të reja si dhe kafshëve racore të importuara.**

Amendamenti 15

Neni 46, Paragrafi 1 rreshti 1, pas fjalës “Ministria” shtohet “, **Këshilli i blegtorisë**”.

Amendamenti 16

Neni 48, Paragrafi 2 riformulohet :

2. Kriteret për selektimin, vlerësimin dhe njohjen e kafshëve të racës rregullohen me Akt nënligjor nga Ministria.

Amendamenti 17

Neni 50 Paragrafi 3 riformulohet :

3. Kriteret për kryerje të riprodhimit të kafshëve të racës duhet të përcaktohen me Akt nënligjor nga Ministria.

Amendamenti 18

Neni 51, Paragrafi 1, fjala “gjallëri” bëhet “**vitalitet**”.

Amendamenti 19

Neni 53, Paragrafi 3 riformulohet :

3.Kriteret për implementimin e mbarsimit percktohen me Akt nënligjor nga Ministria.

Amendamenti 20

Neni 66, Paragrafi 1, të rregullohet rinumërimi i Nenparagrafeve dhe Nënparagrafi 1.2. të riformulohet :

1.2. Fakulteti i Bujqesise dhe Veterinarisë i **Universitetit të Prishtinës** përfaqësohet me 2 (dy) anëtar ;

Amendamenti 21

Neni 71, Paragrafi 5, Nënparagrafi 5.1., fjala “hyr” zëvendësohet me “**rexhistruar**”.

Amendamenti 22

Kreu XIII, titulli bëhet : **KONTROLI dhe INSPEKTIMI** ndërsa në titullin e **Nenit 72** mbetet vetëm fjala **Inspektori**.

Amendamenti 23

Neni 74, në titull fshihet fjala “**një**”.

Amendamenti 24

Neni 75, në titull mbetet vetëm fjala **Kundërvajtjet** dhe fshihet Paragrafi 1.

Amendamenti 25

Neni 77, numri 5 bëhet 2.

5. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani në këtë pikë të rendit të ditës sugjeroi të shtyhet shqyrtimi i dy raporteve të monitorimeve për shkak të përkthimeve jo të kryera dhe mungesës së deputetit që ka udhëhequr me ato monitorime, ndërsa anëtarët e komisionit u njoftuan për ftesën e datës 17 prill në hotelin SIRIUS ku është ftuar Komisioni rreth temës për Teknologjinë mjedisore nga Instituti për menaxhimin e materialeve të aplikuara kryesuar nga dr. Michael Knaus.

Mbledhja përfundoi në orën 13,10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

